

Në bazë të nenit 29.paragrafi 2,pika 3 të Ligjit për veprimtarit komunale (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi” nr. 55/16, 74/16, 2/18, dhe 66/19,) te nenit 38 paragrafi 1 pika 2 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi”, nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22 dhe 84/22) dhe nenit 58 paragrafi 1 pika 2 e Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, numër 48/19 dhe 5/24) Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur 28.10.2024, miratoi

VENDIMIN

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT NË VENDIMIN E SH.P.K. “UJËSJELLËS DHE KANALIZIMI” ULQIN PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË UJIT DHE SHFRYTËZIMIN E KANALIZIMIT TË QYTETIT (Çmimores) PËR VITIN 2025. NR.1529 NGA DATA 28.06.2024

Neni 1.

Jepet pëlqimi në Vendimin e SH.P.K. „Ujësjiellës dhe kanalizimi“ Ulqin për përcaktimin e çmimit të ujit dhe shërbimeve për shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në Komunën e Ulqinit për vitin 2025, miratuar nga Bordi i Drejtorëve me nr.1529, date 28.06.2024.

Vendimi i SH.P.K. “Ujësjiellës dhe Kanalizimi” Ulqin për përcaktimin e çmimit të ujit dhe shërbimeve për shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në Komunën e Ulqinit për vitin 2025. nr.1529, nga data 28.06.2024 është pjesë përbërse e këtij vendimi.

Vendimi nga paragrafi 2 i këtij neni është marrë me pëlqimin paraprak të Agjensisë Rregullative për Energji dhe Shërbime të Rregulluara Komunale Nr.24/1716-20 të datës 31.07.2024.

Neni 2.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e botimit në “Fleten Zyrtare të Malit të Zi – rregulloret komunale”

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02-016/24-485/4
Ulqin, 28.10.2024

KRYETARJA
Ivana Popović, d.v.

D.O.O. "VODOVOD | KANALIZACIA" ULCINJ
SH.P.K. "UJËSJELLËS DHE KANALIZIMI" ULQIN
Br./Nr. 1529
Ulcinj/Ulqin, 28.06.2024 godine.

Në bazë të nenit 54 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 055/16 datë 17.08.2016, 074/16 datë 01.12.2016, 002/18 datë 10.01.2018, 066/19 datë 06.12.2019, 140/22 datë 16.12.2022), Metodologjinë për përcaktimin e çmimeve për ushtrimin e veprimtarive komunale të rregulluara ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 037/23 datë 31.03.2023, nr. 034/24 datë 12.04.2024), nenit 30, paragrafi 1, pika 9 të Statutit të SH.P.K. "Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Ulqin, bordi i drejtorëve në mbledhjen e XX (njëzetë) të rregullt, mbajtur, më 28.06.2024 ka miratuar këtë:

VENDIM

Për përcaktimin e çmimit të ujit dhe shërbimeve për shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në territorin e Komunës së Ulqinit për vitin 2025

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohen çmimet e reja për pagesën e kompensimit për konsumin e ujit nga ujësjiellësi publik dhe shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në zonën e Komunës së Ulqinit. Të gjitha organizatat ekonomike, institucionet, artizanët privatë, punëtoritë hotelierike, institucionet e ndërmarrjeve publike, sipërmarrësit dhe qytetarët janë të detyruar që për shërbimet e kryera të konsumit të ujit dhe shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit të paguajnë kompensimin sipas tarifës së këtij Vendimi të përcaktuar më poshtë.

Neni 2

Në përputhje me metodologjinë për përcaktimin e çmimeve për ushtrimin e aktiviteteve të rregulluara komunale, përdoruesit janë të detyruar të paguajnë kompensimin për konsumin e ujit dhe shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në mënyrën dhe çmimin e përcaktuar si më poshtë:

Uji:

| | |
|---|--------|
| Pjesa fikse e çmimit të ujit (ÇFU) | 3.7477 |
| Pjesa e ndryshueshme e çmimit të ujit (SNU) | 1.3157 |

Kanalizimi:

| | |
|---|--------|
| Pjesa fikse e çmimit të kanalizimit (ÇFK) | 1.2094 |
| Pjesa e ndryshueshme e çmimit (ÇNK) | 0.4388 |

Neni 3

Diten e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi nr. 1210 datë 05.07.2023.

Neni 4

Çmimi i përcaktuar me këtë Vendim do të aplikohet në ditën e marrjes së pëlqimit nga Kuvendi i Komunës së Ulqinit - Themeluesi.

Kryetari i Bordit të drejtorëve
Dritan Pulti, d.v.